



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 13293 (31005-01376-86-2017) Rregj. Them
Data Regjistrimi 20.03.2017

Nr. 5237 (86-2017-5570) Vendimi
Datë 13.12.2017

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR- Kastriot SELITA
GJYQTAR - Altina NASUFI
GJYQTAR - Bernina KONDI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore [REDACTED] në Tiranë, sot me datë 13.12.2017, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

PADITËSE: [REDACTED], e bija e [REDACTED] dhe [REDACTED] e datëlindjes [REDACTED] lindur dhe banuese në [REDACTED]

I PADITUR: Rektorati i Universitetit Bujqësor Tiranë.

Person i tretë: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Tiranë.

OBJEKTI: Anullimin e vendimit nr. 31, datë 11.10.2016 të Rektorit të Universitetit Bujqësor Tiranë si i pabazuar në prova dhe në ligj.

BAZA LIGJORE: Kodi i Procedurës Civile neni 202, 203, 204, 324, 325, 328, 329. Kodi i Procedurave Administrative neni 4, 5, 6, 12, 13, 14, 17, 107, 108, 109, 113, 180. Ligji nr. 49/2012 neni 7, 11, 15/a, 17, 18, 28, 29, 30. Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë" dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar). Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të çështjes me vendimin nr. 125, datë 25.01.2017 ka vendosur:

1. *Rrëzimin e kërkesëpadise së paraqitur nga paditësja Glenda Sallaku, si të pabazuar në ligj.*
2. *Shpenzimet gjyqësore lihen në ngarkim të palës paditëse.*

Kundër ketij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 diteve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

Kundër vendimit Nr 125 datë 25.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka bërë ankim pala paditëse, drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit duke argumentuar se :

- Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është kontradiktore në përmbajtje. Gjithashtu gjykata ka keqinterpretuar ligjin e zbatueshëm në rastin konkret dhe vendimin unifikues nr. 7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Argumentet e paraqitura nga pala paditëse gjetën mbështetjen e Komisionerit të Mbrojtjes nga Diskriminimi, fakt ky që nuk e pengoi gjykatën në zhvlerësimin që i bëri këtyre argumenteve.
- Gjykata nuk ka zbatuar ligjin procedural në lidhje me kompetencën. Kjo pasi, edhe pse gjykata ka konkluduar se çështja i përket juridiksionit civil dhe jo atij administrativ, nuk ia ka dërguar aktet për gjykim Gjykatës kompetente, por ka disponuar me rrëzimin e padisë.
- Gjykata ka pranuar prova në gjykim nga pala e paditur në kundërshtim me procedurën ligjore. Ky pretendim del nga fashikulli i gjykimit dhe regjistrimi audio në CD i seancës gjyqësore. Në dosjen gjyqësore janë futur një numër i madh provash për të cilat paditësja nuk ka qenë në dijeni, duke mos e njohur paditësen me to dhe vënë në dispozicion. Këto prova janë të listuara në këtë ankim nga ana e paditëses, pas shqyrtimit nga ana e saj të fashikullit të gjykimit.

Sa më sipër pala paditëse kërkon prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e padisë sipas objektit të saj.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankimin e paraqitur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

VËREN

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 31.10.2016 me kërkesë padi duke kërkuar:

1. Anullimin e vendimit nr. 31, datë 11.10.2016 të Rektorit të Universitetit Bujqësor Tiranë si i pabazuar në prova dhe në ligj.

Pala paditëse në lidhje me këto kërkitime ka referuar si bazë ligjore në Kodi i Procedurës Civile neni 202, 203, 204, 324, 325, 328, 329. Kodi i Procedurave Administrative neni 4, 5, 6, 12, 13, 14, 17, 107, 108, 109, 113, 180. Ligji nr. 49/2012 neni 7, 11, 15/a, 17, 18, 28, 29, 30. Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë" dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar). Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 125, datë 25.01.2017, ka vendosur: Rrezimin e padisë.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka paraqitur ankim pala paditëse brenda afatit ligjor.

Konstatohet se ankimi i paraqitur nga pala paditëse është përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, pasi janë verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tij, sipas neneve 46 dhe 48 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative" e për rrjedhojë, është shoqëruar me vendimin e gjyqtarit që ka pranuar ankimin.

Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet ankimeve të palëve ndërgjyqëse në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 125, datë 25.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezulton se:

Paditësja [REDAKTUAR] në Qershor të vitit 2008, ka mbrojtur gradën shkencore "Doktor i Shkencave". Dy vjet më pas në datën 19.04.2010, paditësja ka fituar me konkurs vendin e lektorit në Perimtari pranë Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit në Fakultetin e Bujqësisë së Mjedisit në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Me tej në qershor të vitit 2014, paditësja ka fituar titullin akademik "Profesor i asociuar".

Në kuadër të angazhimit si lektore në Departamentin e Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit në Fakultetin e Bujqësisë së Mjedisit, paditësja ka zhvilluar mësim në disa module mësimore pranë këtij Departamenti.

Me Vendimin nr. 31, datë 11.10.2016 të Rektoratit të Universitetit Bujqësor të Tiranës është vendosur që, paditësja nga personel akademik në Departamentin e Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit të kalojë me të njëjtën emërtesë në Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve pranë këtij Fakultetit.

Me marrjen dijani mbi këtë vendim, paditësja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi duke kërkuar anulimin e tij si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Pas depozitimit të kësaj padie, me kërkesë të veçantë drejtuar gjykatës, paditësja ka kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë, pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 31, datë 11.10.2016 të Rektoratit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, kërkesë që është refuzuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë me vendim të ndërmjetëm si kërkesë e pabazuar në ligj e në prova.

Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 31.10.2016 me kërkesë padinë me objekt, palë të paditura dhe bazë ligjore siç përshkruhet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimin të çështjes me vendimin nr. 125, datë 25.01.2017 ka vendosur: Rrezimin e kërkesë padisë së paraqitur nga paditësja [REDAKTUAR], si të pabazuar në ligj.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 125, datë 25.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka arritur në këtë vendim duke argumentuar se:

1. Në nenet 59 dhe 64 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" është parashikuar mënyra e punësimit dhe kohëzgjatja e këtij punësimi të personelit akademik të Institucioneve të Arsimit të Lartë, por nuk janë parashikuar rregullimet ligjore në lidhje me mënyrën apo me pasojat që sjell ndryshimi i marrëdhënieve të punës së personelit akademik siç ka ndodhur në rastin konkret.
2. Në mungesë të një parashikimi ligjor në lidhje me këtë, duhet referuar në dispozitat e Kodit të Punës, që rregullojnë marrëdhëniet juridike të punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, e konkretisht nenet 4 dhe 23 të K. Punës.
3. Nga faktet dhe provat e administruara në seancë gjyqësore, rezulton se ndryshimi i kushteve thelbësore të kontratës së punës është bërë në mënyrë të njëanshme (unilaterale) nga ana e palës së paditur duke cënuar vullnetin e punëmarrësit (paditëses).
4. Nga ana e paditëses është kërkuar anulimi i Vendimit nr. 31 datë 11.10.2016 të Rektoratit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, duke e trajtuar atë si akt administrativ individual.
5. Në lidhje me këtë kërkim të paditëses, gjykata thekson se, ndonëse Vendimit nr. 31, datë 11.10.2016 të Rektoratit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, objekt kundërshtimi gjyqësor është një akt individual i nxjerrë nga Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës në ushtrim të kompetencave të tij ligjore, mosmarrëveshja objekt gjykimi, nuk është e natyrës administrative, por mosmarrëveshje që rrjedh nga marrëdhëniet e punës, marrëdhënie kjo që gjen rregullim në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".
6. Sa më sipër, paditësja nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj padie me objekt goditjen e aktit administrativ objekt gjykimi, pasi një kërkim i tillë bie ndesh me vendimin unifikues nr. 7, datë 01.06.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
7. Duke qenë se nga ana e paditëses është kërkuar anulimi i vendimit nr. 31 datë 11.10.2016 "Për kalimin e znj. [REDAKTUAR] nga Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit në Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve" Objekt gjykimi proceduralisht ajo nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj padie, pasi ligji nuk i njeh asaj si individ asnjë interes të ligjshëm në ngritjen e kësaj padie.
8. Sipas nenit 23 të Kodit të Punës paditësja nuk ka qenë e detyruar të zbatonte Vendimin nr. 31, datë 11.10.2016 të punëdhënësit, pasi ky urdhër ndryshonte kushtet e kontratës pa pëlqimin e punëmarrësit (paditësit). Kjo dispozitë, parashikon një shmangie nga detyrimi i bindjes së punëmarrësit ndaj punëdhënësit. Ky detyrim është një nga detyrimet më të rëndësishme që qëndron në themel të marrëdhënies së punës, të cilin punëmarrësi është i detyruar ta respektojë, duke iu bindur urdhërimeve të dhëna nga punëdhënësi.

9. Nëse nga moszbatimi nga ana e paditëses i Vendimit nr. 31, datë 11.10.2016 objekt gjykimi do të vinte përfundimi i marrëdhënies së punës, atëherë i vetmi interes i ligjshëm që paditësja mund të kërkonte në gjykatë është e drejta e dëmshtëpërblimit nëse provonte si të bazuar pretendimin e saj, se largimi nga detyra është bërë në kundërshtim me ligjin.

Kundër vendimit Nr 125 datë 25.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka bërë ankim pala paditëse siç është përshkruar në pjesën hrëse të këtij vendimi.

Në këto rrethana Gjykata Administrative e Apelit i shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi duke analizuar tërësinë e rrethanave faktike, ankimin e paraqitur ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, si dhe aktet e dosjes objekt gjykimi në referim të përcaktimeve të ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, të vendimit objekt ankimi, të akteve të dosjes si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit të posaçëm dhe atij procedural që gjejnë zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: vendimi nr. 125, datë 25.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të priset dhe çështja duhet të pushohet, për shkak se jemi para një padie që nuk mund të ngrihet nga pala paditëse.

Gjykata në vlerësim të shkaqeve të ankimit, si dhe akteve të dosjes vlerëson se në rastin konkret objekt gjykimi është vendimi nr.31, datë 11.10.2016 "Për kalimin e znj. [REDAKTUAR] nga Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit në Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve", që pretendohet nga paditësja se ka sjellë pasoja ndaj saj.

Gjykata çmon se ky vendim i Rektorit të Universitetit Bujqësor Tiranë është një akt në lidhje me kalimin e paditëses [REDAKTUAR] nga Departamenti i Hortikulturës në Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një akt administrative por me shprehje të vullnetit të punëdhënësit në lidhje me pozicionin e punës-me departamentin ku do të ushtrohet puna nga ana e paditëses.

Në këtë kuptim, kërkimi i paditëses në lidhje me shfuqizimin e vendimit nr. 31, datë 11.10.2016 të Rektorit të Universitetit Bujqësor Tiranë, pa kërkuar zgjidhjen e pasojave është një kërkim i cili nuk ka objekt, pasi akti që kundërshtohet nuk është një akt administrativ, por një vullnet për ndryshimin e kushteve të kontratës së punës këto rrethana, për të cilat mund të kërkohet vetëm rregullimi i pasojave të ardhura, rregullimi i të cilave nuk rezulton të jetë kërkuar nëpërmjet kësaj padie. Gjykata Administrative e Apelit çmon se padia e ngritur nga paditësja, nuk ka objekt dhe nuk referohet në asnjë prej përcaktimeve të nenit 17 të ligjit nr. 49/2012.

Në nenin 15 të ligjit nr. 49/2012, "E drejta e ngritjes së padisë" përcaktohet se:

"Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: a) çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik; b) organi i administratës publike, që pretendon se është cenuar në ushtrimin e kompetencave nga një akt administrativ apo nga një akt nënligjor normativ i paligjshëm, i një organi publik, me të cilin nuk ka lidhje varësie hierarkike. Në këtë rast, organi shtetëror mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës dhe/ose shfuqizimin e aktit;c) punëmarrësi ose punëdhënësi

për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënës është një organ i administratës publike;ç) çdo subjekt që pretendon se është cenuar në të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme të organit publik, që nuk kanë formën e aktit administrativ;d) çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik i) nga një akt normativ;ii) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj;dh) çdo subjekt tjetër, të cilit kjo e drejtë i njihet shprehimisht me ligj”.

Ndërsa neni 17 pika 1 e po këtij ligji përcakton se:1. “*Padia ngrihet: a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;b) për ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ apo detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ;c) për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;ç) për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë;d) për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ, që nuk prodhon pasoja juridike, nëse paditësi ka një interes të arsyeshëm për këtë;dh) për saktësimin e të drejtave dhe të detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit publik; e) për detyrimin e organit publik për të kryer apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo të interesave të paditësit;ë) për përcaktimin e organit që ka në kompetencën e tij zgjidhjen e çështjes konkrete, duke urdhëruar kur është rasti dhe shfuqizimin e aktit të nxjerrë nga organi jokompetent;f) për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, sipas ligjit të posaçëm;g) për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike”.*

Kalimi i paditëses [REDAKTUAR] nga Departamenti i Hortikulturës në Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve është një e drejtë e organit administrativ-Rektoratit të Universitetit Bujqësor të Tiranës i cili rezulton të jetë me cilësinë e punëdhënësit në rastin konkret. Ky veprim është një shprehje vullneti e palës punëdhënëse por që nuk përbën në vetvete një akt administrativ.

Në këtë kuptim, në rastin konkret, nuk jemi përpara një akti administrativ, por përpara një shprehje vullneti për kalimin e paditëses nga një departament në një tjetër. Është akti administrativ ai i cili sjell pasoja juridike dhe që për ligjshmërinë e të cilit ligji ka parashikuar kundërshtimin e tij si parakusht për zgjidhjen e pasojave. Ndërsa në mosmarrëveshjet në kuadër të marrëdhënies së punës, ligjvënësi ka parashikuar si të drejtë në kuptimin procedural, të drejtën e ngritjes së padisë për zgjidhjen e pasojave. Në rastin konkret, rezulton që pala paditëse, nuk ka kërkuar zgjidhjen e pasojave nëpërmjet kësaj padie, por thjesht ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 31, datë 11.10.2016 të Rektorit të Universitetit Bujqësor Tiranë.

Në kushtet kur nuk ka një akt administrativ, padia e ngritur nga pala paditëse është një padi pa objekt e për këtë shkak gjykimi i kësaj padie nuk mund të vazhdojë, si dhe në rrethanat kur nuk është kërkuar zgjidhja e pasojave të ardhura nga vullneti i njëanshëm i punëdhënësit në kuadër të kontratës së punës, gjykimi i çështjes duhet të pushohet.

Sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë duhet të kishte disponuar me mospranimin e padisë, duke iu referuar faktit që padia nuk ka objekt, pasi akti i kundërshtuar nëpërmjet saj nuk është një akt administrativ dhe

pavarësisht nga ky fakt pala paditëse nuk ka kërkuar zgjidhjen e pasojave në lidhje me mosmarrëveshjen në kuadër të marrëdhënies së punës.

Për sa u përket referuar referuar përcaktimeve të nenit 50 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi nr. 125, datë 25.01.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është marrë në zbatim të gabuar të përcaktimeve të neneve 17 dhe 32 të ligjit nr. 49/2012 dhe si i tillë ai duhet të priset dhe gjykimi i padisë duhet të pushohet për shkak se referuar objektit të saj, kjo padi nuk mund të ngrihet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 50 gërma "d" të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI

1. Prishjen e vendimit nr. 125, datë 25.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Pushimin e gjykimit.
3. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
4. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 13.12.2017

GJYQTAR
Bernina KONDI
d.v

GJYQTAR
Altina NASUFI
d.v

GJYQTAR
Kastriot SELITA
d.v

Vërtetohet njësisht me origjinalin

✓ KANCELAR

Leonard STRATAJ



